

V E N D I M
Nr. 31, datë 20.1.2001

**PËR PËRFITIMET NGA STATUSI I INVALIDIT PARAPLEGJIK DHE
TETRAPLEGJIK**

*(Ndryshuar me VKM nr. 302, datë 27.6.2002; nr. 619, datë 7.9.2006; nr. 871, datë 18.6.2008;
nr. 1689, datë 17.12.2008; nr. 326, datë 12.3.2009)*

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 21 të ligjit nr.8626, datë 22.6.2000, "Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik", me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP) në rreth shqyrton të gjitha kërkesat e paraqitura nga personat e bërë paraplegjikë apo tetraplegjikë, për shkaqe që lidhen me punësimin, të cilët përfitojnë nga ligji nr.8626, datë 22.6.2000.

Komisioni vendos edhe shkallën e invaliditetit, sipas ndarjes që vijon:

I. Grupi i parë, ku përfshihen:

a) të sëmurët tetraplegjikë, që kanë humbur mbi 55 për qind të aftësisë për punë, që nuk kanë mundësi fizike për të vetëshërbyer e që kanë nevojë për kujdestar.

b) të sëmurët paraplegjikë, që kanë humbur mbi 55 për qind të aftësisë për punë, që nuk kanë mundësi fizike për të vetëshërbyer e që kanë nevojë për kujdestar.

II. Grupi i dytë, ku përfshihen të sëmurët paraplegjikë pjesërisht të aftë për punë të përzgjedhur, që janë në gjendje për të vetëshërbyer.

2. KMCAP-ja i lëshon të interesuarit raportin mjekësor, duke përcaktuar shkallën e paaftësisë dhe nevojën për kujdestar. Invalidi, paraplegjik ose tetraplegjik, duhet të deklarojë para administratorit shtetëror emrin e kujdestarit i cili shënohet në një regjistër të veçantë. Ndërrimi i kujdestarit mund të bëhet sa herë që invalidi, paraplegjik ose tetraplegjik, e sheh të arsyeshme, por është i detyruar të njoftojë menjëherë KMCAP-në.

3. Invalidët, paraplegjikë ose tetraplegjikë, pajisen me dëshmi zyrtare identifikimi.

4. Masa e përfitimit për invalidët, paraplegjikë dhe tetraplegjikë, është 8 700 (tetë mijë e shtatë qind) lekë në muaj dhe kjo masë indeksohet, çdo vit, me ritmet e rritjes së pagës minimale, në shkallë vendi, por masa e indeksuar e pagesës të mos jetë më shumë se masa e pensionit minimal në qytet, në shkallë vendi. Kjo pagesë përfitohet pavarësisht nga mosha dhe të ardhurat, që përfitojnë nga shteti. Kujdestari i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik, i caktuar në përputhje me pikën 1 të këtij vendimi, përfiton një pagesë, në masën 9200 (nëntë mijë e dyqind) lekë në muaj.

Vendi dhe mënyra e dhënies së këtyre pagesave do të përcaktohet në udhëzimin që do të dalë në zbatim të këtij vendimi.

4/1. Periudha e shërbimit si kujdestar, për invalidin paraplegjik dhe tetraplegjik, i cili nuk është ekonomikisht aktiv, si dhe nuk përfiton të ardhura nga skema e sigurimit të detyrueshëm shoqëror, vlerësohet periudhë sigurimi, për efekt përfitimi pensioni, barrë lindje, aksidenti në punë dhe sëmundje profesionale, dhe sigurimi shëndetësor.

Kontributi paguhet në bazë të pagës minimale, për efekt të llogaritjes së kontributit të sigurimit të detyrueshëm shoqëror, dhe përballohet nga Buxheti i Shtetit.

4/2. Shërbimi Social Shtetëror, mbështetur në informacionin e dërguar nga njësitë e qeverisjes vendore, harton listat e kujdestarëve përfitues, çdo vit dhe sa herë ndryshon kjo listë, në bazë të të cilave përllogariten fondet, që nevojiten për pagesën e kontributit për këtë kategori

personash. Procedurat për zbatimin e kësaj pike përcaktohen në udhëzimin e përbashkët të Ministrit të Financave dhe Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

5. Efektet financiare për këto pagesa të përballohen brenda fondeve të dhëna për vitin 2001, Administratës së Përgjithshme të Ndihmës dhe Shërbimeve Sociale, në zërin “Përfitim paaftësie”.

6. Personat që do të fitojnë statusin e invalidit, paraplegjik ose tetraplegjik, para datës 30 qershor 2001, do ta përfitojnë këtë pagesë, në zbatim të pikës 4 të këtij vendimi, që nga data e hyrjes në fuqi të ligjit nr.8626, datë 22.6.2000, “Statusi i invalidit, paraplegjik ose tetraplegjik.”

Të gjithë personat e tjerë që do ta fitojnë këtë status pas datës 30 qershor 2001, do ta përfitojnë këtë pagesë një muaj pas daljes në KMCAP.

7. Për çdo shpërdorim, personit përgjegjës i merret dëshmia për një periudhë deri në 3 vjet dhe, sipas rastit, zbatohen edhe dispozitat për kundërvajtjet administrative deri në kallëzim për ndjekje penale.

8. Ngarkohen Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale dhe Ministria e Financave të nxjerrin udhëzimet përkatëse, në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta